



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,  
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione  
Mbledhja nr. 25  
Prishtinë, më 15. 1. 2009, ora 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N -10

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni Radmila Vujoviq,  
Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Drita Maliqi, Shpresa  
Murati, Naim Rrustemi dhe Vezira Emrush – anëtarë.

Të ftuar ishin: përfaqësuesit e Asociacionit të të Diplomuarve në Institucionet e Arsimit  
të Lartë Privat: Lulëzim Krasniqi, Muhamet Koci dhe zëdhënësi i Asociacionit.

Mbledhjen e monitoruan: përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësuesi i KDI-së dhe  
mediat etj.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinatar, zyrtar i lartë ligjor.

*Për këtë mbledhje u propozua ky*

**R e n d i t e**

- 1 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
- 2 Takim me përfaqësuesit e Asociacionit të të Diplomuarve në Institucionet  
e Arsimit të Lartë Privat,
3. Të ndryshme.

*Rendi i ditës u miratua me plotësimin e pikës të tretë të rendit të ditës.*

***Kryesuesi*** konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e  
pikës së parë të rendit të ditës.

## 1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

*Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar. I përshëndeti mysafirët dhe i njoftoi të pranishmit për përmbajtjen e takimit.*

## 2 Takim me përfaqësuesit e Asociacionit të të Diplomuarve në Institucionet e Arsimit të Lartë Privat,

**Muhamet Koci** - Para anëtarëve të Komisionit i shtroi problemet e mosnjohjes së diplomave. Theksoi se përfaqësuesit ndihen të diskriminuar për shkak se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nuk ua njeh zyrtarisht diplomat. Pra me vendim të Qeverisë, të diplomuarve në universitetet private nuk u njihen diplomat, edhe pse këto universitete kishin licenca për punë. Universiteti i Prishtinës nuk i njeh këto diploma si valide, në mënyrë që poseduesit e tyre të kenë të drejtë të marrin pjesë në konkurs për regjistrim në studimet master në kuadër të këtij universiteti. Në këtë mënyrë të diplomuarve në universitetet private u mohohet e drejta për vazhdimin e studimeve master në Universitetin Publik. Ky asociacion shpreh mendimin se me këto veprime të diplomuarve në universitetet private u mohohen të drejtat themelore njerëzore të fushës së arsimit. Lidhur me këtë pikë u hap debat.

**Lirim Krasniqi** – Duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësit shtoi se me vendimin e Qeverisë së Kosovës nuk janë dëmtuar pronarët e universiteteve private, por vetëm studentët, sepse ato po funksionojnë dhe se MASHT- i nuk ka mundur ta mbyllë IALP-në. Me tutje ceku se jemi taksapagues të shtetit të Kosovës dhe se institucionet e kanë për obligim ta zgjidhin këtë çështje. Ai i njoftoi të pranishmit se pakënaqësinë e tyre do ta shprehin edhe me protesta.

**Prof dr. Nerxhivane Dauti** – Diskutimin e filloi me mendimin e Viktor Hygos: “Hapja e një shkollë - mbyllje e një burgu”. Ajo u pajtua me diskutimet e paraqitura dhe shtoi se, sa i përket dokumentacionit, e drejta qëndron në anën e tyre. Kërkoj që t’u mundësohet vazhdimi i studimeve postdiplomike në Universitetin Publik. Kam dijeni si kanë rrjedhur gjërat dhe si kanë dalë pengesat. Ligji i arsimit e rregullon këtë fushë dhe ua mbron të drejtat atyre. Pyeti se cilat fakultet private i përfaqësonin.

**Naim Rrustemi** - Ua përkujtoi se Ministria e Arsimit ua njeh diplomat e fakulteteve private. Mirëpo rekomandimi preferon të mos lejohet regjistrimi i studentëve. Në rast se do të shpallen konkurse për regjistrim në shkallën e tretë, do të jenë të barabartë. Kërkesë e tyre është të njihen këto diploma nga strukturat udhëheqëse të Universitetit të Prishtinës.

**Hajredin Hyseni** - Kërkoj sqarim për problemet e krijuara dhe pyeti a janë ato të Universitetit të Prishtinës, të Ministrisë së Arsimit apo të një fushe më të gjerë. Nga kjo po shihet se UP-ja nuk po e zbaton Ligjin e arsimit.

**Ismet Beqiri** – Duke u ndërlidhur me çështjen e ngritur tha se mungon vendimi për njohje nga ana e Qeverisë së Kosovës. Këtu kemi të bëjmë me dy çështje:

- mosnjohja e diplomave dhe moslejimi i regjistrimit në shkallën e tretë në Universitetin Publik dhe
- mosnxjerrja e vendimit nga ana e Ministrisë së Arsimit.

**Vezira Emrush** – Ishte e mendimit se për këtë çështje duhet të ndriçohen dy gjera relevante: e para, kush është ligjdhënës? Në këtë rast, sipas saj, Ministria dhe Qeveria. E dyta, kush është zbatues i ligjeve? Në këtë rast, Universiteti Publik, që këtë çështje e ka paraparë edhe me statut, si akt më të lartë juridik. Kërkoi që ministri i Arsimit të marrë vendim për njohjen e diplomave të universiteteve private dhe të vërtetojë a janë në pajtueshmëri me sistemin e Bolonjës, nga se Kosova është në fazën e integrimi, në të cilën duhet të respektohen standardet. Për këtë çështje ajo e fajëson ministrin e jo studentët, që janë viktima. Hapjen e fakulteteve Qeveria e konsideron si hapjen e qoshqeve.

**Sanije Alijaj** - Veprimet e institucioneve shtetërore i vlerësoi si shkelje të së drejtës themelore të njeriut. Shtoi se kjo çështje është ngritur si pyetje (mocion) parlamentare për njohjen e diplomave të universiteteve private, për të cilat është thënë publikisht se njihen. Kërkoi që Komisioni t'i drejtohet Ministrisë së Arsimit me një shkresë që kjo kategori e diplomave të shqyrtohet dhe të mundësohet realizimi i së drejtës për vazhdimin ose për regjistrimin e studimeve të shkallës së tretë.

**Drita Maliqi** – U pajtua me shumicën diskutuesve. Kërkoi nga Komisioni të mbahet një dëgjim publik me përfaqësuesit e Asociacionit dhe me ministrin e Arsimit, në të cilin do të njoftohen institucionet e arsimit se ku po shkelet Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Lidhur me këtë pikë pati propozime për mbajtjen e dëgjimit publik.

*Në mbledhje u zhvillua një debat i gjerë përkitazi me këtë problematikë. Komisioni u zotua se për këtë çështje, në një mbledhje që pritet të mbahet javën e ardhshme, do t'i japë rekomandimet e veta.*

### **3 Të ndryshme**

**Ismet Beqiri** – I propozoi Komisionit të ftohet ministri i Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti, më 20. 1. 2008, që të shqyrtohet peticioni i nënshkruar nga një grup oficerësh dhe rreshterësh të Divizionit të Sigurimit Policor të Kosovës dhe propozoi të nxirret ky:

#### **Përfundim**

1. U vendos që Komisioni, më 20. 1. 2009, në orën 13.30, ta mbajë një takim me ministrin, Zenun Pajaziti, në të cilin do të njoftohet hollësisht për peticionin e një grupi oficerësh dhe rreshterësh të Divizionit të Sigurimit Policor të Kosovës.
2. Gjithashtu u pajtua që takimi të përcillet nga mediat.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 00.

**Kryetari i Komisionit**

---

Ismet Beqiri